

LIGJ

Nr.7904, me 8.3.1995

PER DISA NDRYSHIME NE LIGJIN NR.7643, DATE 2.12.1992 "PER INSPEKTORATIN SANITAR SHTETEROR"

Ne mbeshetje te nenit 16 te ligjit nr.7491, date 29.4.1991
"Per dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Keshillit
te Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

VENDOSI

Neni 1

Ne ligjin nr.7643, date 2.12.1992 "Per inspektoratin sanitar
shteteror" behen ndryshime si me poshte:

- Ne nenin 3, ne fund shtohen fjalet "ose te ngarkuar me
keto funksione".

- Ne fund te nenit 8 shtohet paragrafi: "Autorizohet
Ministria e Shendetesise dhe e Mbrojtjes se Mjedisit te nxjerre
rregullore higjieno sanitare, te detyrueshme per zbatim nga
ministrite dhe organet e tyre vartese, si dhe nga personat fizike
e juridike, vendas e te huaj".

-Ne nenin 26, pika 2, ne fund te paragrafit shtohen fjalet:
"Kur keto ndokojne negativisht ne shendetin e njeriut".

-Ne nenin 26, pika 10 ndryshohet si me poshte:
"Ndotja e burimeve dhe e objekteve te tjera te ujit te
pijshem dhe derdhja e ujerave te institucioneve te ndryshme pa u
dezinfektuar ose dezaktivizuar".

-Ne nenin 27, ne paragrafin e pare, fjalet "neni 27"
zevendesohen me fjalet "neni 26". Ne paragrafin me me permbajtje
"Shkeljet e parashikuara ne pikat 10, 11, 12, 13, 15" shtohet dhe
pika 9. Ne paragrafin e parafundit heqet fjala "ambulante" dhe ne
kete paragraf shtohen fjalet "pa te drejte ankimi".

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi menjehere.

Shpallur me dekretin nr. 1043, date 20.3.1995 te Presidentit te
Republikes se Shqiperise, Sali Berisha